

**Gjergj Fishta’s comedy *Patuku’s tricks* as a textual “trick”
for the introduction of Molière to the Albanian audience**

Abstract: *The article aims to describe, analyze, and interpret Molière’s comedy Les fourberies de Scapin adapted by Gjergj Fishta as Patuku’s tricks through a parallel approach. When the most important author of French classicism and Gjergj Fishta, one of the most prominent writers in our literary tradition meet, though born centuries apart, it is normal to believe that such encounter can potentially produce a discussion of literary interest. Over a long period of time, the readership and critics alike have pointed out the importance of this translation and the translator himself who allowed a French author to reach an audience otherwise far from the French milieu. Throughout this article, the echo of some researchers’ opinions on Fishta’s orientation towards Molière is addressed, including the importance he gave to the main character of this comedy, as a playwright and stage director. The text translated by Fishta in Albanian as Dredhít e Patukut is also examined, along with the many transformations it undergoes in its adaptation, either in terms of plot, dramatic action, characters, or language.*

Based on the changes in the plot lines, the removal and addition of various characters, the changes in stage directions and the dialogues of the original text compared with its adaptation, it can be concluded that the original text served Fishta more as a paratext, on which he relied to build an almost new comedy, which would entertain Albanian audience.

Keywords: *Comedy, translation, adaptation, character, dramatic action, the language of the literary work.*

Hyrje

Sa herë që vihesh përballë një teksti letrar të përkthyer në gjuhën tonë, nuk ka sesi të mos mendosh edhe për vështirësitë e hasura nga përkthyesi për hyrjen në gjuhën vendase të veprës së huaj. Aq më tepër rritet vlerësim-gjykimi për këtë prurje, kur lexuesi dhe kritika për një hark të gjerë kohor e ka dëshmuar rëndësinë e këtij përkthimi ose përkthyesi, i cili bën të mundur takimin e një shkrimtari të huaj me një lexues, për të cilin autori

nuk ka pasur asnjë njohje. Kur bëhet fjalë për autorin më të rëndësishëm të klasicizmit frëng, Molierin, si dhe shkrimtarin, ndër më të spikaturit e traditës sonë letrare, Fishtën, nuk ka sesi ky takim me një vonesë prej disa shekujsh të mos prodhojë tension ose së paku, një turbullirë.

E nisëm këtë shkrim edhe prej faktit se studiues të ndryshëm, mbase me të drejtë, komeditë e Molierit të sjella në shqip prej Fishtës, nuk i kanë përfshirë në korpusin origjinal të dramave të këtij të fundit.¹ Duke u ndalur veçmas tek komedia “Dredhët e Patukut”, do të përpiqemi të argumentojmë se ndryshimet e mëdha mes tekstit origjinal dhe përshtatjes, në rrethanat që u bënë dhe si u realizuan, mbartin vulën shqiptare të satirikut tonë françeskan.

Në qasjen ndaj kësaj vepre të sjellë në shqip, nuk mund të mënjanohet metoda historike, që lidhet edhe me rrethanat e vakëta letrare e kulturore të kohës kur u përkthye vepra. Një vëzhgim tjetër i rëndësishëm ka të bëjë me përqendrimin tek shfaqjet teatrale që i dhanë jetë këtij shqipërimi. Ky shkrim do të ngrihet edhe falë krahasimit mes të dy pjesëve (origjinalit dhe përshtatjes), për të gjetur ngjashmëritë dhe ndryshimet mes tyre. Më pas do të zbritet në mikroanaliza për të përfunduar në interpretimin e ndryshimeve të përmbajtjes, të strukturës, të karaktereve, të dialogut. Do të përfshihen edhe të dhëna sasiore, për të mbërritur në përfundime sintetizuese rreth marrëdhënies së tensionuar tjetërsuese mes tekstit origjinal dhe kësaj përshtatjeje.

Sainte-Beuve (1804-1869) është një ndër kritikët më të famshëm francezë. Ai në shkrimet e tij pajton dhe përdor në mënyrë të moderuar kritere të ndryshme. Kalon nga erudicioni në përshtypje, nga historia në psikologji, nga klasifikimi në vlerësim. Ka një stil të zhdërvjellët impresionist.² Në njërin prej portreteve të tij letrare për komediografin e famshëm, ndër të tjera shprehet se Molieri i përket shekullit në të cilin ka jetuar, për mënyrën e paraqitjes së disa veseve të veçanta dhe për përdorimin e kostumeve teatrale, por mbi të gjitha ai i përket çdo epoke dhe të gjithë njerëzimit.³

Sipas kritikut: “Molieri, midis gjenive është më i pajisuri me fantazi krijuese, mbase ai edhe ka imituar më shumë se të tjerët, duke prekur pak ngado. Ky është një tipar tjetër që i përbashkon poetët primitivë popullorë

1 “Në një shkrim të vonë bibliografik gjejmë që Fishta, po u përjashtuan adaptimet (përshtatjet) ka hartuar nëntë tekste dramatike”. HAMITI, *Letërsia moderne shqipe*, 39.

2 MUZZIOLI, *Le teorie della critica letteraria*, 59

3 “Molière est du siècle où il a vécu, par la peinture de certains travers particuliers et dans l'emploi des costumes, mais il est plutôt encore de tous les temps, il est l'homme de la nature humaine. SAINTE-BEUVE, *Portraits littéraires*, https://obvil.sorbonne-universite.fr/corpus/sainte-beuve/sainte-beuve_portraits-litteraires-ed-nouv_02

me dramaturgët e famshëm që erdhën pas tyre”.⁴

Pikërisht kështu lëviz edhe pikëvështrimi ynë përgjatë këtij shkrimi, duke rindërtuar epokën, rrethanat, qarkun në të cilin erdhi Molieri si autor i rëndësishëm, duke u ndalë tek interesi për personalitetin e autorit dhe veçanërisht tek përshtatja e pjesës “Les fourberies de Scapin”.

Studiuesi i letërsisë frënge, Ilia Lëngu, shprehët: “Molieri mbetet një mjeshtër i madh në krijimin e karaktereve. Një pjesë e mirë e tyre jo vetëm që i kanë rezistuar kohës, por janë shndërruar në emra simbolikë. Dhe kjo është një arritje e madhe e artit të Molierit, i cili atë që mori nga jeta ia riktheu asaj me gjenialitetin e vet. Teatri i Molierit i kapërceu kufijtë e kohës e të hapësirës. Së bashku me Shekspirin, Molieri është pa dyshim një nga dramaturgët më të mëdhenj e më popullorë të teatrit botëror”.⁵

Hyrja e Molierit, e shkrimtarit të komedisë së shëndetshme franceze, nga sistemi letrar i gjuhës frënge, në brishtësinë e një sistemi letrar me një gjuhë të mbijetuar si shqipja, kërkonte shpatulla të forta për barrëmbajtjen e atij stili klasik që shpallte njerëzoren, të vërtetën, arsyen dhe të bukurën si parime dhe ideale të patjetërsueshme.

Ardhja e Molierit në skenën shqiptare

Shkodra, qyteti kryesor i Veriut të Shqipërisë, ka qenë gjithmonë një vatër atdhetarie, identiteti kulturor dhe arti. Si qyteti kryesor i vendit, jo vetëm nga tradita e pasur dhe e hershme kulturore, por edhe nga popullsia dhe aktiviteti ekonomiko-shoqëror, Shkodra mund të quhet qyteti i lindjes dhe i gjallërimit të teatrit shqiptar.

Me fillimet e teatrit dhe të shoqërive të ndryshme amatore lindi nevoja për një repertor pjesësh të huaja, aq më tepër edhe për autorë të mëdhenj të klasicizmit evropian, ndër të cilët spikat Molieri. Përzgjedhja e këtij autori, përfaqësues jo aq besnik i rregullave strikte të teatrit klasik, lë të kuptohet se ishin të gjitha gjasat që ai të pëlqej nga publiku shqiptar. Dihej botërisht se për Molierin, si për të gjithë gjenitë e letërsisë, vlente mbi gjithçka liria e krijimit letrar. Kjo ishte rregulla më e madhe e të gjitha rregullave. Sipas tij, komedia duhet ta bëjë spektatorin të vetëkorrigjohet duke qeshur. Kjo cilësi u quajt *katharsis* komik. Të pastrohesh shpirtërisht nëpërmjet së qeshurës.

Për të mbërritur nyjetimi i tekstit të Molierit ndër shqiptarë, të cilët sapo i gëzoheshin zgjedhjes së një alfabeti latin, në grahmat e Perandorisë

4 Ivi., “Molière, le plus créateur et le plus inventif des génies, est celui peut-être qui a le plus imité, et de partout ; c’est encore là un trait qu’ont en commun les poètes primitifs populaires et les illustres dramatiques qui les continuent”. https://obvil.sorbonne-universite.fr/corpus/sainte-beuve/sainte-beuve_portraits-litteraires-ed-nouv_02

5 LËNGU, *Teatri i Molierit dhe shoqëria frënge e shekullit XVII*, (parathënie), në *Komedi të zgjedhura*, Molier, 19-20.

Osmane, duhej edhe guximi i madh që të shtërngosh veten të qeshësh, për të mos qarë. Fishta e njihte mirë parimin e komedisë franceze “të mësojmë duke qeshur”, prandaj duket se ia hyri kësaj pune duke u ushqyer prej rrënjëve tragjike të historisë së vendit tonë. Shqipërimi i Molierit prej Fishtës është mishërim i rrënjëve tragjike të komikut.

Në vitet e para të Pavarësisë teatri bulëzoi në Shkodër dhe natyrisht vëmendjes së poetit Gjergj Fishta, si përkrahës i këtij arti skenik, nuk kishte se si t’i shpëtonte Molieri. Françeskani i ditur solli të përshtatura komeditë e këtij autori, si: “Dredhët e Patukut”, “I ligu për mend”. Këto komedi kishin bërë një rrugëtim të gjatë në skenat e Evropës, kur mbërritën në skenën amatore shkodrane. Ishte momenti kur ishte hapur sipari i historisë edhe për shtetin shqiptar. Në një sprovë krahasuese të Stefan Çapalikut “Fishta dhe Molieri” shtrohen pyetjet: “Çfarë ka marrë Fishta nga Molieri? Pse është shkruar në to: “Punue mbas Molierit”? Çfarë i ka shtuar Fishta Molierit? Çfarë ka lënë pa marrë Fishta nga Molieri? Ç’vend zë përthimi, adaptimi apo rikrijimi? Ja pra disa nga nga çështjet themelore rreth të cilave mendoj të sillem duke diskutuar mbi komedinë “I sëmuri imagjinar” i Molierit dhe “I ligu për mend” i Fishtës. Për të parën arsyeja është e thjeshtë. “Mjek përdhuni ka mbetur dorëshkrim dhe nuk dihet se ku ndodhet, arsyeja e dytë është krejt komike e tragjike njëkohësisht se “Dredhitë e Patukut”, teksti në shqip, nuk gjendet në asnjë bibliotekë të Shqipërisë në një kohë kur gjendet në frëngjisht, italisht, anglisht, rusisht, bile edhe kinezçe”.⁶

Për vetë historinë e çuditshme, objekt i hulumtimit në këtë shkrim është komedia “Dredhët e Patukut”, e cila u fsheh për 50 vjet nën parketin e një shtëpie shkodrane.

“Të njëjtin fat si autori i saj ka pasë edhe vepra Dredhit e Patukut. Asht ruejt me kujdes për ma shumë se pesëdhjetë vjet nën dysheme - parket druni në një shtëpi shkodrane të z. Luigj Baba. Ky zotni fisnik prej Shkodre pati mirësinë me ja kthye Bibliotekës Françeskane “At Gjergj Fishta” në Shkodër”.⁷

Ky dorëshkrim i Atë Gjergj Fishtës, që ishte një përshtatje në shqip e komedisë së Molierit “Les fourberies de Scapin”, që vënë në skenë me dhjetëra herë nga shoqëritë teatrore amatore, të cilat përpiqeshin të mbushnin jetën kulturore në një Shqipëri, që ishte në udhëkryq të historisë në fillimshkullin XX. Me këtë rast mund të na ndërmendet studiuesja e teatrit, Suzana Langer, kur shprehet: “Ç’është e vërteta personalitetet komike shpeshherë janë paloço, të marrë, klouna, por personazhe të tilla gjithnjë zgjojnë simpati dhe ndonëse i godasin dhe i keqtrajtojnë ato janë të pashkatërrueshme dhe vazhdimisht me plot vetëbesim dhe me tipare të

6 ÇAPALIKU, *Fishta dhe Molieri-Një sprovë krahasuese*, Gazeta “Rilindja”, 8

7 FISHTA, *Dramatika III*, 8.

mira.”⁸

I tillë është edhe Patuku i Fishtës që ndjek gjurmët e Scapin-it të Molierit. Merita e shkrimtarit tonë është se identifikon një karakter mjaft domethënëse të komedisë franceze, që është frymëzuar nga “*commedia italiana dell’arte*”. Kjo ishte një vepër jo shumë e suksesshme në gjallje të Molierit. U interpretua vetëm 17 herë nga trupa e tij, por më vonë pati një sukses të jashtëzakonshëm.

Jehonë të madhe patën personazhet e Molierit edhe ndër spektatorët shkodranë. Kështu shfaqje pas shfaqjeje Molieri, i shqipëruar prej Fishtës, filloi të njihej edhe nga spektatori që kishte mbetur në errësirën e gjatë të pushtimeve.^{9 1011} Molieri vinte i përkthyer në të folmen e Shkodrës, që siç e vëren më vonë edhe hartuesi më i mirë i fjalorëve frëngjisht-shqip dhe shqip - frëngjisht, Vedat Kokona, është e folmja me ngjashmëritë më të mëdha fonetike me frëngjishten.¹²

Lëvizja teatrale në Shqipëri zhvillohej në kuadrin e shoqërive amatore. Natyrisht që historia e dramës duhet parë e lidhur me historinë e teatrit. Nuk mund ta ndash tekstin dramatik nga loja skenike, ashtu siç nuk mund ta ndash “gjuhën” nga “ligjërimi”. Do të pajtohem me mendimin se në letërsinë kombëtare mungonte një traditë parafishtiane. “Por, megjithëse drama ishte një gjini jo e suksesshme për kohën, Fishta e lëvroi atë gjithë jetën, paralelisht me gjinitë e tjera,” - pohon studiuesja Lili Sula tek “Drama e Fishtës, sprovë për tipologjinë e saj.”¹³

Qasjen e Fishtës ndaj komikes e vlerëson shumë vjet më vonë edhe Alfred Uçi, në periudhën e vetëreflektimit të tij për çështje estetike të disa shkrimtarëve të anatenuar nga regjimi. Ndër të tjera, në shkrimin “Gjergj Fishta tue ngjitur bishta”, cituar nga vepra “Pesë të mëdhenjtë e letërsisë shqipe në optikën e një rileximi”, Uçi shprehet: “Prirja drejt komikes dhe groteskut nuk ka qenë diçka e jashtme dhe artificiale në gurrën poetike të Fishtës, por një nga shfaqjet më organike në talentin e tij të madh, të nginjur në ujërat e traditave me të mira të humorit e satirës popullore. Vetveten poeti e ka quajtur “Fishta që vë bishta”. Kredua e tij komike është

8 LANGER, *Ritmi komik*, në F. HYSAJ (ed.), *Teatrollogji, dramaturgjia, regjiturë dhe aktrim* – (antologji), 182.

9 *Bri Taraboshit, N’Vaso Pasha*: Gazeta “Taraboshi”, Shkodër, 2-3 shkurt 1914, 2-3.

10 *Nji copë e Moliere perkthye nën emrin “I ligu për mend” nga i nderti at Gjergj Fishta*, Gazeta “Zani i Popullit”, nr. 124, 1 janar 1928, 4.

11 *Dredhinat e Patukut*” Gazeta “Ora”, nr. 192, Tiranë, 11 tetor 1930, 4.

12 “Për shqiptimin e grafisë **œ**, që ka rëndësi të madhe në frëngjisht, duhet imituar tingulli i shkodoranishtes në fjalët **voe** dhe **vinì roe**. Ky shqiptim duhet mësuar mirë se është i domosdoshëm edhe për zanoren hundore **un** që do ta shënojme me grafinë **œ**.” KOKONA, *Fjalor frëngjisht – shqip*, 7.

13 SULA, *Drama e Fishtës, sprovë për tipologjinë e saj*, 32.

shprehur, nga njëra anë, në fjalët e Horacit “castigat ridendo”...”¹⁴

Fishta ishte në të njëjtën gjatësi vale me këtë lloj katarsisi përmes humorit e satirës, po aq sa ç’ishte edhe për rrëfimin, si pjesë e misionit të tij teologjik e letrar, ndaj përshtati në shqip disa nga veprat e këtij komediografi të madh francez. Veprimi skenik me plot kthesa të papritura të ngjarjeve, kontrastet e forta, dialogu dinamik, ndërtimi i karaktereve dhe mesazhet që konsistojnë në fitoren e së mirës, ndaj së keqes, virtytit ndaj vesit, domethënë triumfin e drejtësisë, do të ishin lehtësisht të receptueshme për spektatorin e kohës.

Komeditë e Molierit për nga parimi i arsyes dhe i së vërtetës që pasqyrohej në to, e kishin tejkaluar epokën e tyre dhe duhej të ishin të pranueshme për fuqinë e tyre shprehëse edhe për shqiptarët. Duke e marrë të mirëqenë kulturën letrare të Fishtës në lëmë të autorëve klasikë, mund të supozohet që përmes shqipërimeve të veprës së komedianit të famshëm, ai është përpjekur edhe për një lloj realizmi, si dhe për një lloj leximi e kuptimi të qartë të komedive nga spektatorët e kohës, duke përzgjedhur pikërisht ato vepra që ishin më të prekshme. Qëllimi i zgjedhjes së komedive të Molierit mbase kishte të bënte më faktin se tek ai ka personazhe më të arsyeshëm. Natyrisht nuk besohet në ngjashmëritë e sistemeve letrare midis atij shqiptar dhe francez, të cilat nuk kanë pasur as lidhje, as kushte të ngjashme të prodhimit dhe të receptimit. Individualiteti krijues i Molierit është i papërsëritshëm. Po kështu, Fishta, edhe pse në një kohë më të vonë dhe në një hapësirë shumë më të mbyllur letrare, nuk duket se është autor i izoluar. Në veprat e tij shfaqen një varg parimesh dhe tendencash që kanë luajtur rol në mbarë procesin letrar shqiptar. E tillë është edhe kjo komedi, si një akt përshtatjeje i Molierit, pikërisht për t’i dhënë një hov cilësor këtij procesi letrar.

Ndikimi frymëzues i Molierit tek Fishta

Një vështrim i shkurtër i orientimit të Fishtës ndaj Molierit mund të gjendet tek artikujt që e vërejnë këtë ndikim. Mund të merret në analizë se i çfarë lloji është ky ndikim, duke theksuar aspektin tipologjik, por edhe largesën në kohë.

Justin Rrota kujton: “Qytetarët, ndrÿ dyerët e oborrit me reze e me shula që prej kumbonës s’akshamit grumbullue rreth votret kuvendshin pa e çue zânin. Posë ndonji zogu ogurzi, a vaji së naj fëmije rrall t’a ndiejsh kund një kangë, një gaz a brimë, qi të rrëfejtë se mbas atyne mureve të nalta gjallojshin gjindë.

Ndërkaqë, mbrenda salonit të vogël të Shkollës Françeskane, në mjedis së naj çete djelmoçash Shkodranë, gjindej P. Gjergji.

14 UÇI, *Pesë të mëdhenjtë e letërsisë shqipe në optikën e një rileximi*, 73.

Sod, për fat të keq, ata neofitë Shqyphtarë, për sa dijnë un, nuk janë mât! S'është mât ai i shuemi Karl Suma, Loro Matija, Lec Pistulli, Tish Topçija, Prek' Jaku... të cilët do të kishin dijtë të na kallxojnë mât mirë, shka ndodhte, por sidomos shka u folte ndër ato bashkime Poeti.

Gatoheshin për t'i çilun sÿt Shqyphtarit nëpër të çfaqunt e ndonji argtimi në gjûhë shqype. Me kaqë me i diftue popullit - kundra rrymës s'atëhershme - se Shqypja nuk ishte një zhel për t'u përbuzun; se, edhe nëpër të mund të shpreheshin mirë, kÿartë e bukur ndjeri ndiesÿt ma të hajtat.

Pionieri kishte fillue me komedÿt e të madhit Molière: "Gjok Tarçuku"- "Mjek për dhunÿ", "I ligu për mend" etj. shqypnue e zbrû si dihte veç ai."¹⁵

Në librin "At Gjergj Fishta 1871-1940" numër përkujtimor botuar nën kujdesin e At. Benedikt Dema OFM, studiuesi Henrik Lacaj shkruan: "Frymë origjinale kanë edhe dy komedit e përshtuna mbas Molière "I ligu për mend" dhe "Dredhÿt e Patukut". At Fishta tue u ndjejun mjaft besnik, në të thurun, vepravet të auktorit freng, ka dijtë t'i mveshi ato dy pjesë gaztore me një natÿrsi fjesht shqipe; jetën shoqnore e sidomos familjare të Shkodrës ndër kohët e ma parshme e pikzon me aftësi të rrallë. Aty paraqitet jeta reale e përditshme me të gjitha ngatrrerat, dredhet e hypokrizit që përdorë bota. Frazelogjia e pasun dhe plot krypë, në të cilën At Fishta tregohet mjeshtër i vërtetë e i pashoq, u ep gjallnë e humor dialogëve dhe skemave. Tipat e ndryshëm janë vërtetë të nxjerrun nga jeta dhe sajojnë në mes të tyre kontraste të pikatuna të cilat shkaktojnë ilaritet dhe e mbajnë lexuesin ase spektatorin në një gaz shpirtnuer të vazhdueshëm."¹⁶

Më pas në të njëjtin botim studiuesi Zef M. Harapi sjell këtë konsideratë në shkrimin "Fishta në lamë teatrale": "Në komedi si "I ligu për mend" e "Dredhÿt e Patukut" harti dramatik është i plotsuem, pse, nonsë punue mas Molière, ka dijtë aq mjeshterisht me u veshë jetën shpÿjake e thjesht shqyptare, gjith herë tue pasë për qëllim të përmirsuemt e dokeve, tue vûe në gaz punët e pagiashme: koprraci, dhandrri, ungji, nipi, sherbtori, djali, mjeku janë pikzue bukur e mas së vërtetës. At Fishta ia kalon Goldonit për gjallsi të dhjalogut, natÿrsi të karakterit, stil populluer e sidomos për kah pastrija e gjuhës e e mndÿrës së thanieve."¹⁷

Nga studimi "Teatri i Shkodrës" i autorit Josif Papagjoni citojmë: "Vetëm gjatë vitit 1914 kjo shoqëri (Shoqëria artistike "Vaso Pasha") vuri në skenë edhe disa pjesë të autorëve të njohur botërore si: "Dredhitë e Patukut" (përshtatje e verpës së Molierit "Dredhitë e Skapenit"), Cubat e Shilerit,

15 RROTA, *Me Pater Gjergjin*, në A. B. DEMA OFM (ed.), *At Gjergj Fishta 1871-1940* (numër përkujtimuer), 141-142.

16 LACAJ, *At Fishta në dramatikë*, në A. B. DEMA OFM (ed.), *At Gjergj Fishta 1871-1940* (numër përkujtimuer), 256.

17 HARAPI, *Fishta në lamë teatrale*, në A. B. DEMA OFM (ed.), *At Gjergj Fishta 1871-1940* (numër përkujtimuer), 261

Filja e T. Kerner etj”.¹⁸

Citimet e mësipërme kanë pohuar origjinalitetin e një përshtatjeje, e cila mund të konsiderohet si një përpunim i tekstit të Molierit nga Fishta që nuk ecën në kundërshtim me orientimin e origjinalit, por që relativizohet duke vënë në pah ndryshimet mes kontekstit të vjetër të fjalës së huaj në komedinë franceze dhe kontekstualizimit të saj të ri në skenën shqiptare.

Vërehet se këto përshtatje janë raste të një ndërtektorësie, veçanërisht intensive. Ato nuk janë përkthime të thjeshta e besnike prej një gjuhe në një tjetër. Zhvendosja e komedisë së Molierit të shekullit XVII, përmes penës së Fishtës, në fillimshekullin XX nuk është thjesht një zhvendosje prej një sistemi shenjash në tjetrin. Bëhet fjalë për një përpunim të mirë dramatizues, duke ruajtur pjesën më të madhe të kuptimit të tekstit edhe falë magjepsjes që ka përshtatësi për autoritetin e autorit. Gjithsesi teksti “Dredhít e Patukut” nuk është një përkthim i motivuar vetëm nga kjo magjepsje. Mendojmë se paraqitja më e imtësishme tekstore e këtyre ngjashmërive dhe ndryshimeve midis komedive të Molierit, të përshtatura nga Fishta, ripohon në mënyrë më të argumentuar ndeshjen kuptimore në ndërtimin e ngjarjes, personazheve, hapësirës, kohës, replikave etj.

Roli i aktorit në shfaqjet e shqipëruara nga Fishta

Në Gjimnazin Françeskan, “Dredhít e Patukut”, komedi me tre akte e Molierit e përkthyer shqip dhe e përshtatur nga At Gjergj Fishta, u shfaq me rastin e karnavaleve. Fishta e kishte kuptuar që në krye të herës se një shfaqje teatrale ka shumë elemente: muzikën, efektet me drita, skenografinë, dramaturgun dhe regjisorin. Të gjitha këto nuk e zëvendësojnë rëndësinë e një aktori të mirë. Pa aktorin e mirë nuk ka shfaqje teatri të suksesshme.

Në këtë komedi, në rolin e Patukut, u shfaq për herë të parë Zef Hilëgega.¹⁹ Aktorë të tjerë ishin: Lazër Gurakuqi, Kolë Kodheli, Kolë Kamsi, Ndoc Lezhja, Luigj Skanjeti.

“I ligu për mend” komedi me tre akte e Molierit, edhe kjo e punuar nga At Gjergj Fishta, me po atë liri, sikur ndodh në Shkodër, përjashtonte rolet e femrave. Dy komeditë u shfaqën brenda viteve 1912-1918 nga aktorë të tjerë. “Tartufi”, komedia e famshme e Molierit, edhe kjo e përpunuar nga Fishta, u vu në skenë më 1914. U interpretua shumë herë deri në vitin 1917.

Zef Hilëgega (1864-1948), që mishëroi aq mirë rolet e komedive të

18 PAPAGJONI, *Teatri i Shkodrës*, 11.

19 “Fishta e kishte njoftë vetë personalisht Zefin, e kishte pa disa herë në shfaqjet e tija [...] N’atë vjetin e largët 1910, i entuziazmuem nga talenti i rrallë i Zefit, Fishta ia hyni punës për të përshtatë në gjuhën shqipe komedinë me nam “Les fourberies de Scapin” të Molierit edhe vetë titullit të së cilës i dha një shprehje të thellë logjike, leksikore e popullore, tue e quejtë “Dredhitë e Patukut”. SHLLAKU, *Maska shkodrane - Kur lindej teatri*, 156.

Molierit, njihej si një ndër komikët më të shquar të artit diletant shkodran për një periudhë 30 vjeçare.

“Qe trupmadh, fytyrë thatik e të vrarë leje, jo i pashëm, por simpatik edhe pse i vranët. Që në shfaqjet e para fitoi nam të madh si në rolin e Patukut. Unë, për të, që në vegjëli kam ushqyer simpati të veçantë. Loja e tij në skenë më bindte dhe në të njëjtën kohë më entuziazmonte. Zë të ëmbël bariton e pak si të marrur, diksion të qartë e të plotë, çdo batutë me frymë popullore me vërtetësi të përsosur, saqë edhe kur teksti ishte naiv, logjika e tij e ngrinte në frymë reale. Këto ishin disa nga karakteristikat e tij. I shkathët në gjeste, duart e tij shprehnin plotësisht gjerësisht mendime, fjalë e sidomos nëntekste. Sytë e gjallë me inteligjencë të rrallë. Kishte një mënyrë të tijën dramatike të veçantë, që të bënte të qeshësh...”, kështu e kujton autori Andrea Skanjeti tel libri i tij.²⁰

Zef Hilëgega kishte interpretuar edhe te komedia “Tartufi”.

“I ligu për mend” u përsërit edhe më 19 shkurt 1938 nga grupi i Loro Kovaçit. Ndër afishet e kësaj shfaqjeje ishte shkruar: ‘Komiku i famshëm Zef Hilëgega e luante këtë pjesë për herë të fundit’. Kur mbaroi shfaqja Zefi i qeshur doli përpara siparit dhe iu drejtua publikut më këto fjalë: ‘Kanë gabuar kur kanë thanë se kjo është shfaqja e fundit. Jo! Këtu në skenë do të më takoni përsëri. Mirë u pafshim!’ Mund të kuptohet se me çfarë ovacionesh u pritën këto fjalë kujton”, - kujton Skanjeti.²¹

Dëshmia më e bukur e bashkëpunimit të Fishtës më aktorin Zef Hilëgega na vjen nga studimi “Maska shkodrane - Kur lindej teatri” i autorit Lec Shllaku ku, veç të tjerave, autori na përshkruan edhe bashkëpunimin e frytshëm tekstori në përshtatjen e kësaj komedie. Shllaku përshkruan edhe dialogun që bëhej mes tyre për një përkthim sa më të mirë të tekstit “ala franga” në një gjuhë të kuptueshme për shqiptarët. Ky bashkëpunim në shqipërim e bëri tekstin e Fishtës shumë më të kuptueshëm.

“Kur mbas disa ditësh (Fishta) ia rilexoi, Zefi u shtang e u kënaq. Por ma shumë u kënaq Poeti i madh. ‘Patuku im tashti ka marrë edhe miratimin e Zef Hilës, - i tha të vllaut, Sebastianit e disa kolegëve të vet të shkollës’. Asistoi disa herë në prova e qeshte me lot prej Patukut - Zef e partnerëve të tij”.²²

Në këtë lloj atmosfere u ngjiti në skenën shqiptare Patuku i Fishtës.

Fabula e komedisë së Molierit “Les fourberies de Scapin”

Ndërkohë që Argante është në një udhëtim për tregti, i biri Octave, duke përfituar nga kjo mungesë dashurohet marrëzisht dhe martohet

20 SKANJETI, 100 vjet teatër në Shkodër 1879-1979, 73.

21 Ibid., 121.

22 SHLLAKU, “Maska shkodrane - Kur lindej teatri”, 156-157.

fshehurazi me një vajzë të re, të varfër, por me një origjinë të panjohur, Hyacinte-n. Në të njëjtën kohë edhe Léandre, i biri i Géronte, i cili gjithashtu është në të njëjtin udhëtim tregtie, ka rënë në dashuri me Zerbinette-n, një vajzë egjiptiane. Argante kthehet në qytet me besimin se duhet të martojë të birin, por tashmë martesë e tij është kryer. Octave është shumë si i shqetësuar se si do ta përjetojë i ati lajmin e martesës së të birit. Nisur nga ky shqetësim ai detyrohet t'i kërkojë ndihmë Scapin-it, që është shërbëtori i Léandre-it. Duke besuar tek aftësitë e tij si "mjeshtër i intrigave", Scapin ndërmerr disa hapa veprimi që do të ndikojnë në vendimet e plakut Argante. Ky i fundit i tregon Géronte-it informacionin e fshehtë, që ka marrë nga pakujdesia e Scapin-it, sipas të cilit Léandre ka bërë disa faje. Léandre, pasi qortohet rëndë nga i ati, vrapon tek Scapin për të demaskuar tradhtinë e tij. Megjithatë kjo gjendje dhe nevoja që ai ka për ndihmë e mposht pakënaqësinë. Léandre këshillohet me Scapin-in si mund të gjejë para për të paguar shpërbimin që i kërkojnë egjiptianët, për të mos e rrëmbyer Zerbinette-n. Scapin-i i talentuar për dredhira, arrin t'i zhvasë shumën e rënë dakord të dy pleqve (Argante-s dhe Géronte-s). Shërbëtori i zgjuar, Scapin, hakmerret edhe ndaj Géronte-it, që e ndëshkoi atë përballë Léandre-it. Ai sajton se i ashtuquajtur vëlla i Hyacinte-s do ta vriste Léandre-in, nëse anulohet martesë. Gjoja për ta shpëtuar, Scapin-i e fut në një thes Géronte-in. Duke u shtirë si shpëtarët hakmarrës që po e kërkonin, ai i jep ca goditje të forta Géronte-it të fshehur në thes. Shumë shpejt mashtrimi i Scapin-it do të zbulohet. Shërbëtori i shpëton ndëshkimit falë shmangies së situatës, ku zbulohet që Hyacinte është vajza e humbur e Géronte-it dhe Zerbinette është e bija e Argante-s. Në fund, duke u shtirë si një njeri në prag të vdekjes pas një aksidenti, shërbëtori dredharak falet nga dy pleqtë pasanikë.

Dredhít e Patukut - Shndërrimet

Shqipëruesi ka pasur parasysh interpretimin dhe kufizimin në kohë, që ka teksti letrar i destinuar për t'u vënë në skenë. Ky tekst i përkthyer duhet të jetë në të njëjtën gjatësi vale me kontekstin gjuhësor dhe kulturor. Në tekstin origjinal ngjarjet zhvillohen në qytetin e Napolit (La scène est à Naples). Në tekstin e Fishtës "puna ndodhë në Shkodër".

Në aspektin historik e kohor, ngjarja zhvillohet në aktualitetin e saj, në vitet e para të shekullit XX. Subjekti i Fishtës ndryshon edhe rrjedhën e programit narrativ, veçanërisht *objektin me vlerë*, i cili nuk është gruaja (martesa), por paraja (shlyerja e borxheve). Mishërimi i karaktereve dhe interpretimi i aktorëve është ana tjetër e medaljes.

Po si ndryshojnë personazhet tek teksti i Fishtës?

Së pari, Fishta shqiptarizon personazhet dhe ndryshon të gjithë emrat e tyre. Më poshtë po i paraqesim personazhet në një tabelë përmbledhëse

LES FOURBERIES DE SCAPIN
Comédie

DREDHËT E PATUKUT
komedi tri aktesh
shkrue mbas Molière-it
përshtatë në gjuhën shqipe
prej P. Gjergj Fishtës, O.F.M.

ACTEURS

VEHTJE

ARGANTE, père d'Octave et de Zerbinette. (babai i Octave dhe Zerbinette)	vs	GJOKA	Baba i Lecit
GÉRONTE, père de Léandre et de Hyacinthe. (babai i Léandre dhe Hyacinthe)	vs	TUKJA	Axha i Lecit dhe baba i Linit
OCTAVE, fils d'Argante, et amant de Hyacinthe. (I biri i Argante dhe i dashuri i Hyacinthe.)	vs	LECI (KOLA)	I biri i Gjokës
LÉANDRE, fils de Géronte, et amant de Zerbinette. (I biri i Géronte dhe i dashuri i Zerbinette.)	vs	LINI	Djali i Tukes
ZERBINETTE, crue Égyptienne, et reconnue fille d'Argante, et amante de Léandre. (E besuar si egjiptiane, dhe e rinjohur si vajza e Argante, dhe e dashura e Léandre)			
HYACINTE, fille de Géronte, et amante d'Octave. (E bija e Géronte, dhe e dashura e Octave.)			
SCAPIN, valet de Léandre, et fourbe. (Shërbëtor i Léandre, dhe mashtrues)	vs	PATUKU	Shegerti i Tukes
SILVESTRE, valet d'Octave. (Shërbëtor i Octave)	vs	NUSHI	Shegerti i Gjokës
NÉRINE, dado e Hyacinthe.			
CARLE, mashtrues			
DEUX PORTEURS. (Dy hamej)			
		JETKTARI	Ltini, Antikuariatisti
		KELI	Shitësi
		RROKU	Kalimtar

Suksesi i Patukut, që na dëshmohet edhe nga shtypi i kohës, ka të bëjë me rrugëtimin përkthimor, që endet mes shkurtimeve, shndërrimeve e shtesave.

Veprimi skenik nga komedia origjinale tek përshtatja

Të dhënat e përmendura më lart na dëshmojnë se është ndjekur zanafilla e prurjes së kësaj vepre. Nga pikëvështrimi teorik²³ që ka të bëjë me përkthimet teatrale, vërehet se ato gjithmonë e marrin në konsideratë mediumin e skenës. Një vepër teatrale, që paraqitet përpara një publiku i cili nuk ka njohuri nga konteksti i huaj, rrezikon të mos kuptohet, prandaj autori rikrijon personazhe, situata dhe dialogje të ngjashme për vendin pritës.

Tabela e mëposhtme përshkruan rrjedhën e ngjarjes në të dy tekstet.

Molier "LES FOURBERIES DE SCAPIN" Akti I	Fishta "DREDHËT E PATUKUT" Akti I
Skena 1 Octave sapo është martuar me Hyacinte-n, pa marrë më parë pëlqimin e të atit. Silvester i tregon se i ati i kthyer nga udhëtimi dëshiron ta shohë atë të martuar me vajzën e Géronte – it.	Duka e parë Kola (Leci) ka marrë vesh që Gjoka (i ati) dhe Tukja (xhaxhai) po kthehen nga Trieste. Kola i tregon Nushit për borxhet ku është zhytur dhe punët e këqija që ka bërë.
Skena 2 Octave i tregon Scapin-it se është martuar me Hyacinte-n, ndërkohë që i ati ishte larg, po kështu edhe miku i tij Léandre, i biri i Géronte– it, ka rënë në dashuri me Zerbinette-n, një egjiptiane.	Duka e dytë Kola (Leci) i kërkon ndihmë Patukut (shegertit të Tukes, pra axhës), i cili është mjeshtër për dredhi dhe mashtrime. Patuku i premtan ta nxjerrë nga kjo situatë.
Skena 3 Octave dhe Hyacinte kërkojnë ndihmën e Scapin. Shërbëtori i zgjuar pranon t'i ndihmojë.	Duka e tretë Gjoka ka marrë vesh prapësitë e të birit. Patuku i justifikon prapësitë e Kolës, pasi është i ri. Gjoka i betohet se do ta nxjerrë të birin jashtë shtëpie. Me vëllezërit, Gjokën dhe Tuken, është bashkuar gjatë udhëtimin edhe një Ltí (latin, italian), që është mbledhës vlerash antikuaire.

23 DIADORI, *Teoria e tecnica della traduzione – Strategie, testi e contesti*, 162-170.

Skena 4 Scapin e mbron Octave përballë të atit, Argante, por ky i fundit nuk ndryshon mendje dhe kërkon anulimin e kësaj martese të bërë pa pëlqimin e tij.		
Skena 5 Scapin sajton planin e tij për Sylvestre, të cilin i kërkon të vishet si shpatar.		
AKTI II		AKTI II
Skena 1 Argante i tregon Géronte-it se i biri, Léandre, ka bërë disa gjëra të papëlqyera.		Dukë I Gjoka i tregon të vëllait (Tukes) se edhe i biri i tij dhe nipi, Lini, është përfshirë në disa punë të pista.
Skena 2 Géronte përballë me Léandre-in duke e treguar se është në dijeni të gjërave që kanë ngjarë prej Argante-it. Djali vihet në siklet të madh.		Dukë II Tukja reflekton që prapësitë e Linit, nuk mund të jenë më të mëdha se të Kolës (Lecit), por duhet të pyesë Patukun, shëgertin e vet.
Skena 3 Léandre i kërkon Scapin të rrëfejë tradhtinë e tij. Shërbëtori vetëm zbulon tri hile, duke mohuar të jetë fajtor për atë që akuzohet.		Dukë III Tukja i kërkon të birin t'i tregojë se ka marrë vesh prapësitë dhe vjedhjet e parave, që kanë ngjarë gjatë mungesës së tij dhe të vëllait, Gjokës.
Skena 4 Carle i mëson Léandre-it që duhet të paguajë një shpërblim për egjiptianët, në mënyrë që ata të mos e rrëmbejnë përgjithmonë Zerbinette-n.		Dukë IV Lini zemërohet me Patukun për tradhtinë e tij.
Skena 5 Scapin i vihet punës duke filluar me Argante-in. Ai sajton se Hyacinte ka një vëlla shpatar, që kërkon 200 pistoleta si dëmshpërblim për anulimin e martesës së saj me të birin. Argante përsëri refuzon.		Dukë V Lini takon Patukun, shërbëtorin e shtëpisë, dhe kërkon ta rrahë, por Kola (Leci) i hyn ndërmjet dhe nuk e lejon. Ai e akuzon Patukun se ia ka treguar Tukes të gjitha prapësitë. Patuku i betohet se nuk e ka bërë një gjë të tillë.

Skena 6 Sylvestre i maskuar si shpatar, shfaqet si vëllai i sajuar i Hyacinte-s. I tmerruar Argante i siguron 200 pistoletat që i kërkohen.	Dukë VI Tuti (fajdexhiu) i kërkon Linit borxhet dhe i lë afat deri në mbrëmje për kthimin e parave, në rast të kundërt do ta padisë.
Skena 7 Scapin tani kalon tek plaku tjetër, Géronte. Ai i tregon atij se i biri, Léandre-i, është rrëmbyer nga turqit, të cilët kërkojnë një shpërblim prej 500 koronash për lirim të djalit. Géronte pas një diskutimi të gjatë, pranon të paguajë.	Dukë VII Lini takohet me Patukun dhe i thotë që e ka falur, mjafton që ai t'i mësojë se si t'i gjejnë paratë e marra borxh nga ai dhe djali i xhaxhait, Kola (Leci). Patuku i siguron se këto para ai do t'ia zhvasë pikërisht etërve të tyre.
Skena 8 Scapin lajmëron Octave-in dhe Léandre-in se misioni i tij përfundoi shkëlqyeshëm.	Dukë VIII Patuku monologon se si mund të përfitojë edhe ai diçka për vete nga gjithë kjo mesele.
	Dukë IX Patuku takohet me Jetiktarin (Ltí, latin, italian) me të cilin bën sikur flet në disa gjuhë. Jetiktari i shpjegon se interesohet për gjëra antike.
	Dukë X Patuku përmes ngatërresash gjuhësore dhe mashtrimesh ia shet shumë shtrenjtë një rrobë, gjoja antike, Jetiktarit. Ai i premtun se do t'i gjejë edhe një kandil të vjetër. Rrobat e vjetra dhe të pavlera i ka sjellë Keli (shitësi).
	Dukë XI Patuku dhe Keli bien dakord që ta zhvasin përsëri Jetiktarin dhe t'i ndajnë fitimet së bashku.
	Dukë XII Patuku përqendrohet tek nxjerrja e 20 napolonave për Kolën (Lecin) dhe natyrisht parashikon që këto para do t'ia marrë Gjokës.

		Dukë XIII Patuku sajón historinë e një ngatërrese, që gjoja ka pasur me një malësor, Kola (Leci). Për goditjet që i ka dhënë, i vëllai i këtij malësori është përбетuar, që do ta vrasë Kolën (Lecin). Falë “ndërhyrjes” së Patukut është shmangur kjo gjëmë, por vëllai i malësorit i kërkon të atit (Gjokës) 20 napolona (10 napolona për një armë dhe 10 napolona para në dorë), për ta mbyllur këtë ngatërresë. Ndërhyn Nushi, i cili thotë se nuk duhen të tremben nga këta kërcënime.
		Dukë XIV Gjoka i frikësuar pranon t’ia paguajë paratë malësorëve dhe të mos bëjë padi për kërcënimet e tyre. Gjoka pranon që paratë do t’ia dërgojë Patuku, edhe pse shfaq pak mosbesim ndaj tij. Në fund Gjoka interesohet të dijë për Jetiktarin (Ltí-in), nëse i kishin gjetur gjëra të vjetra.
		Dukë XV Patuku i tregon Nushit për bëmën e tij të fundit dhe i thotë se do të vijojë t’i zhvasë para Tukes dhe Jetiktarit (Ltí-it).
AKTI III		AKTI III
Skena 1 Zerbinette dhe Hyacinte flasin rreth gjendjes së grave. Scapin merr leje për të filluar hakmarrjen e tij.		Dukë I Patuku e bind Kelin që të bëhet bashkëpunëtor i tij për mashtrimin dhe zhvatjen e parave të Jetiktarit (Ltí-it). Keli duhet të hiqet sikur edhe ai është mbledhës antikuaresh nga Rumania. Kështu mund t’i rritet vlera sendeve që kërkojnë të blejë Jetiktari (Ltí-ni).

Skena 2 Scapin e këshillon Géronte-in që të futet dhe të fshihet në një thes, për t'i shpëtuar zemërimit të shpatarëve që po vinin. Ky shërbëtor dredharak shfrytëzon rastin për t'i dhënë disa goditje të forta Géronte-it, por së shpejti do të zbulohet mashtrimi dhe Scapin-i do t'ia mbathë.	Dukë II Patuku sajon dhe i tregon Tukes se disa cuba i kanë marrë peng të birin, Linin. Ata do ta vrasin, nëse ai nuk do t'i paguajë 30 lira. Tukja tërbohët nga zemërimi dhe i kërkon Patukut ta zevëndësoi ai Linin si peng. Më pas kërkon të ulë çmimin duke bërë pazar me jetën e të birit, pastaj bindet dhe paguan 30 lirat.
Skena 3 Zerbinette i tregon Géronte-it, pa e ditur se kush është, rastet e mashtrimeve të Scapin-it për t'i rrëmbyer paratë.	Dukë III Keli dhe Patuku më anë të ngatërresave gjuhësore mashtrojnë sërish Jetiktarin (Ltí-in), duke i shitur një kandil të pavlerë për 14 napolona.
Skena 4 Sylvestre më pas i thotë Zerbinette-s që burri të cilit ajo i tregoi mashtrimin, është vetë viktima e Scapin-it, Géronte.	Dukë IV Patuku, Lini, Leci, Nush e Keli ndajnë paratë që i kanë zhvatur Gjokës, Tukes dhe Jetiktarit (Ltí-it).
Skena 5 Argant-i, ashtu si Géronte, ka një dëshirë të jashtëzakonshme për t'u hakmarrë për vjedhjet dhe mashtrimet e Scapin-it.	Dukë V Patuku ia tregon dhe Tukes historinë e sajuar të ngatërresës së Lecit (nipit) me disa malësorë, të cilët po kërkonin të hakmerreshin edhe ndaj tij. E këshillon që të futet në një thes, për ta shpënë ai në shtëpi duke e mbajtur në kurriz. Ndërkohë Patuku luan rolin e disa malësorëve të zemëruar, të cilët i japin disa goditje të forta me shkop thesit ku fshihet Tukja, por në fund nxjerr kokën dhe zbulon dredhinë e Patukut, i cili ia mbath, i ndjekur nga mallkimet e Tukes.
Skena 6 Argante dhe Géronte janë shumë të pakënaqur. Për më tepër Géronte është shumë i shqetësuar, sepse vajza e tij rrezikon të vritet në një anije.	Dukë VI Tukja i dëshpëruar nga ngjarja takohet më një kalimtar, Rrokun, i cili nuk e njeh Tuken dhe ia tregon me kënaqësi duke u zbavitur gjithë historinë e mashtrimit që i ishte bërë atij prej të birit dhe Patukut. Tukja përbetohet se do ta padisë sa më parë Patukun.

Skena 7 Nérine, e cila është dadoja e Hyacinte-s, njofton Géronte-in se ajo sapo ka martuar vajzën e saj të vogël me Octave.	Dukë VII Gjoka dhe Tukja kanë kanë marrë vesh edhe mashtrimin e bërë ndaj Jetiktarit (Ltí-it) prej Patukut. Ata tani dinë me hollësi, që të gjitha historitë e rrëmbimit të djemve ishin sajesa të shegertit Patuk, për t'i marrë paratë për veten e tij dhe për shlyerjen e borxheve të djemve të tyre.
Skena 8 Sylvestre informon Scapin rreth ngjarjeve të fundit dhe e paralajmëron atë për rrezikun që i kanoset.	Dukë VIII Tuti i njofton Gjokën dhe Tuken se Patuku ka pësuar një aksident. Një gur i ka rënë kokës, ndërsa kalonte poshtë një shtëpie që po ndërtohej. Ai është duke vdekur dhe po vjen t'u kërkojë ndjesën ("hallallëkun") të dy vëllezërve.
Skena 9 Géronte është shumë i lumtur që takon sërish të bijën.	Dukë IX Nisur nga gjendja, Gjoka dhe Tukja e falin Patukun, edhe pse i kishin të freskëta telashet që ai u kishte sjellë së bashku me djemtë. Por edhe ky aksident ishte sajesa e fundit e Patukut, i cili kërkon të jetë në sofër bashkë me të tjerët, duke u ngritur përnjëherësh në këmbë.
Skena 10 Argante takohet me Octave-n dhe i tregon se e bija e Géronte-it, e cila do të duhet të ishte bashkëshortja e tij, është vetë Hyacinte. Megjithatë, Géronte vijon të jetë kundër martesës mes Léandre-it dhe Zerbinette-s.	
Skena 11 Argante vëren një byzylyk në dorën e Zerbinette-s. Ai përmes kësaj stolie zbulon identitetin e kësaj vajze. Zerbinette është pikërisht e bija e tij e humbur.	

Skena 12 Carle u tregon të gjithë të pranishëmve se Scapin-it i kishte ndodhur një aksident, një goditje në kokë dhe ishte duke vdekur.		
Skena 13 Duke parë gjendjen e Scapin-it, Géronte dhe Argante e falin atë edhe pse ai ia kishte punuar keq me mashtrimet e bëra. Më në fund mësohet se ky aksident fatal nuk është gjë tjetër veçse një tjetër dredhi e Scapin-it, pasi ai është shëndosh e mirë.		


Ndryshime mes teksteve

Çfarë e bën përshtatjen e Fishtës të krijojë tension me origjinalin? A e ruan shprehësinë e origjinalit gjuha e Fishtës?

Këto çështje mund të merren në analizë. Ja disa aspekte sasiore dhe cilësore të teksteve që ndryshohen. Në tabelën e përgatitur si më poshtë, bëhet një paraqitje e ndryshimit sasior të replikave në të trija aktet e komedisë. Paraqitja në mënyrë grafike e kësaj tabele replikash të dialogut për të trija aktet e komedive (origjinale dhe të përshtatur), tregon se sa shumë është tjetërsuar teksti i Molierit prej Gjergj Fishtës.

	Akti I (teksti original)	Akti I (teksti i përshtatur)
Skena	Numri i replikave	Numri i replikave
1	29	23
2	46	71
3	41	66
4	107	6
5	4	0
	Akti II (teksti original)	Akti II (teksti i përshtatur)
Skena	Numri i replikave	Numri i replikave
1	22	19
2	28	1
3	59	20
4	38	1

5	61	54
6	40	5
7	93	31
8	15	1
9	0	19
10	0	40
11	0	7
12	0	1
13	0	36
14	0	22
15	0	4
	Akti III (teksti original)	Akti III (teksti i përshtatur)
Skena	Numri i replikave	Numri i replikave
1	30	13
2	39	79
3	21	53
4	6	8
5	5	37
6	11	20
7	16	14
8	7	7
9	2	21
10	21	0
11	5	0
12	7	0
13	21	0



Në total numri i replikave në tekstin e Molierit është 774, ndërsa në tekstin e përshtatur të Fishtës 679. Në aspektin cilësor të përkthimit, që ka të bëjë me përzgjedhjen dhe kombinimin e fjalëve, mund të thuhet se janë bërë tri lloje lëvizjesh:

1. Përkthim thuajse i fjalëpërfjalshëm;
2. Ndryshime fjalësh dhe ruajtje e kuptimit të replikës;
3. Heqje e plotë e replikës / Shtesë e një replike të re.

Për ta ilustruar këtë po sjellim shembuj për dy rastet e para nga teksti original dhe nga teksti i përkthyer:

Molier "LES FOURBERIES DE SCAPIN"	Fishta "DREDHËT E PATUKUT"
	Përkthim thuajse i fjalëpërfjalshëm
SCAPIN, (apporté par deux hommes, et la tête entourée de linges, comme s'il avait été blessé) — Ahi, ahi. Messieurs, vous me voyez... Ahi, vous me voyez dans un étrange état. Ahi. Je n'ai pas voulu mourir, sans venir demander pardon à toutes les personnes que je puis avoir offensées. Ahi. Oui, messieurs, avant que de rendre le dernier soupir, je vous conjure de tout mon cœur, de vouloir me pardonner tout ce que je puis vous avoir fait, et principalement le seigneur Argante, et le seigneur Géronte.	PATUKU - Ahi. Ah! Ahi! Zotni, ju po m'shifni.... Ahi! Ju po m'shifni se m'ç'hall kam vojtë. Ahi! Par kje tuj m'dalë shpirti per gazep, mos t'm'bijshin kta shokë ktû per me ju mârrë hallallin para se me dekë. Ahi! Po, Zotni, para se me kalue n'jetë t'vertetë lypi hallallin per shkado qi kena folë mirë a keq. Ahi! Hallallë bukë e krypë! Lir e bekue!... Ahi! M'a bânî hallallë e sidomôs Zotni Tukja. Ahi!
	Ndryshime fjalësh dhe ruajtje e kuptimit të replikës
"SCAPIN - À vous dire la vérité, il y a peu de choses qui me soient impossibles, quand je m'en veux mêler. J'ai sans doute reçu du Ciel un génie assez beau pour toutes les fabriques de ces gentillesse d'esprit, de ces galanteries ingénieuses à qui le vulgaire ignorant donne le nom de fourberies; et je puis dire sans vanité, qu'on n'a guère vu d'homme qui fût plus habile ouvrier de ressorts et d'intrigues; qui ait acquis plus de gloire que moi dans ce noble métier: mais, ma foi, le mérite est trop maltraité aujourd'hui, et j'ai renoncé à toutes choses depuis certain chagrin d'une affaire qui m'arriva."	"PATUKU - Po, por hall bu, qi un e kam bâ me tobe mos me u perzi mâ n'do pûnë, me pasë me m'u lutë s'di se kush. Sa per me ja gjetë fillen lâmshit e me i bâ do djepa, qi me ja u qitë hallkut pa ndi ujët nen qilim, ti lënma mue; pse (marre me e thânë), por n'ket mjeshtëri kerkush s'mund t'ma dalin. Por ç'dobí, pse hallku kto pûnë i thrasin bataçilleqe, e, madje un me kto mjeshtëri shûm herë jam da lagët, sa qi e kam bâ me tobe mos me hî mâ kurr nder pûnë t'huja, sidomos qyshë se m'ka bollanisë tash nji ditë nji idhnm."
Heqje replike	Shtesë replike

“SCÈNE III HYACINTE, OCTAVE, SCAPIN, SILVESTRE. HYACINTE.— Ah, Octave, est-il vrai ce que Silvestre vient de dire à Nérine? Que votre père est de retour, et qu'il veut vous marier? OCTAVE.— Oui, belle Hyacinte, et ces nouvelles m'ont donné une atteinte cruelle. Mais que vois-je? vous pleurez! Pourquoi ces larmes? Me soupçonnez-vous, dites-moi, de quelque infidélité, et n'êtes-vous pas assurée de l'amour que j'ai pour vous?”	“DUKË III GJOKA, PATUKU e NUSHI n'fund t'theatrit. GJOKA: (tuj kujtue se është vetun). A â ndi kurr një pûnë ksodoret? PATUKU: (Nushit) A e shef ti se i paska ra m'er pûnës, një send qi xêka n'gojë me vedi. GJOKA: (tuj kujtue se është vetun). Qe nji maskarallek. [...]
--	--

Gjuha e komedisë së Fishtës e ruan shprehësinë e origjinalit. Ajo është dialektore dhe me ndikime e ndërhyrje të regjistrir bisedor të kohës, ku bien në sy përdorimi i arkaizmave, turqizmave, huazimeve të tjera në funksion të karakterizimit të personazheve dhe të rritjes së komicitetit të tyre.

Përfundim

Në fund të këtij shkrimi apo kësaj analize të përmbajtjes dhe të formës së komedisë, po i shtrojmë e po i përgjigjemi shkurtimisht disa pyetjeve, si dhe po i lëmë të hapura disa prej tyre.

A e pasuron Fishta Molierin përmes variantit të tij të përkthimit, apo thjesht e përvijon në një mjedis ballkanik? A mund të vihet përsëri në skenë kjo pjesë? A e ruan një lloj aktualiteti ajo?

Duhet vlerësuar rëndësia e prurjes së “Dredhëve të Patukut”, një komedi që nuk u përkthye kurrë më vonë, pavarësisht prej përkthyeshmërisë që pati vepra e autorit.

Në logjikën e thjeshtë të gjërave, ndryshimet sasiore të shpien në ndryshime cilësore. Nga kjo analizë krijohet një ide e saktë për ndryshimet e mëdha që pëson vepra përsa i përket karaktereve, veprimet, dialogut dhe organizmit të skenave në përgjithësi. Të dhënat numerike konkretizojnë hipotezën e ngritur përgjatë këtij studimi, që teksti “Dredhët e Patukut” shkon përtej një përshtatjeje.

Duke parë ndryshimet në linjat e veprimet, në heqjen dhe shtesën e personazheve të ndryshme; duke parë ndryshimet e didaskalive dhe replikave të tekstit të komedisë origjinale përballë përshtatjes së saj, mund të përfundohet se teksti origjinal i ka shërbyer autorit më shumë si një paratekst, tek i cili është mbështetur për të ndërtuar një komedi thuasje

të re, e cila do t'i argëtonte spektatorët shkodranë dhe shqiptarë. Në pikëvështrimin e sotëm gjithë këto ndryshueshmëri midis dy teksteve kaq të largët në kohë, mund të vijojnë të japin kuptim dhe mesazhe të fuqishme për kohën tonë.

Studiuesi Edmond Tupja shprehet se përkthyesi është mjeshtër kur: "...rifjalëzon atë që ka kuptuar nga shfjalëzimi i tekstit në gjuhë të huaj duke e shprehur në gjuhën e vet amtare".²⁴

Ka dy qasje në përkthim: huajëzim dhe amtarëzim. E para lejon elementet e huaja të depërtojnë në kulturën e tjetrit, ndërsa e dyta jo plotësisht. Fishta preferon më shumë pozicionin e dytë. Amtarëzimi i Molierit prej Fishtës ka një vulë të fortë krijuese. Poeti ka përqendruar gjithë kompetecat gjuhësore dhe energjinë krijuese për të mbërritur tek një vepër e rifjalëzuar. Për ta shembullizuar metaforikisht këtë, mjafton të kujtohet karakteri i shtuar i Latinut (antikuaristit, personazhi që mbledh objekte me vlerë antike), i cili nuk ekziston fare në komedinë e shkruar frëngjisht. Brenda këtij karakteri të krijuar duket se është mishëruar në mënyrë komike qëndresa ndaj të huajit, si përfaqësues i "naivitetit" evropian, përballë dredhive të vendasve.

Ajo që i bashkon të dy krijuesit është lidhja e fortë me kulturën popullore, si dhe me teatrin, sidomos për aspektin e tij improvizues.

Shkrimi mori në shqyrtim edhe faktorët që ndërvepruan vazhdimisht për prurjen e tekstit letrar në funksion të shfaqjes skenike. Ky ishte edhe qëllimi i ndalesës në çështjen për rolin e aktorit kryesor, i cili që përfshirë në procesin e një përkthimi bashkëpunues. I ndryshuar me vetëdije në një masë të madhe, ky tekst duhej t'i përgjigjej mundësisë për vënien në skenë dhe receptimit të kohës.

Molieri në Francë, veçanërisht gjatë 2022 (vit jubilar për të), është rivënë në skenë thujtë çdo ditë, në teatro të ndryshëm.

Kjo gjë nuk ka ndodhur më me variantin në shqip. Mund të përditësohej për skenën shqiptare "Dredhít e Patukut", pjesë e cila ka ruajtur freskinë tematike aktuale dhe gjallërinë gjuhësore të gegnishtes. "Les fourberies de Scapin", komedia origjinale e Molierit e rriti suksesin e saj ndër shekuj. Kjo mund të vërehet po të ndiqet kronologjia e vënieve të saj në skenë (rreth 27 herë veç në vitet e fundit)²⁵, që dëshmon përkujdesjen e treguar nga atdheu i klasicizmit, por edhe bota mbarë për komedianin e madh.

Sainte-Beuve, veç të tjerash, vëren se Molieri ishte mosbesues për suksesin e librit ndër librari. Ai preferonte më shumë gjykimin e publikut në teatër.²⁶ Kjo kënaqësi prej fjalës së thënë në teatër karakterizon edhe

24 TUPJA, *Këshilla një përkthyesi të ri*, 25

25 <https://www.theatre-contemporain.net/textes/les-fourberies-de-scapin/mises-en-scene/>

26 "L'École des Maris, dédiée au duc d'Orléans, son protecteur, est le premier ouvrage qu'il ait publié de son plein gré; à partir de ce moment (1661), il entra en communication

Fishtën. Qëllimshmëria autoriale përbashkuese e tyre është për një art që i shërben moralit të mirë e virtytit, gjithmonë duke u mbështetur në popull. “Les fourberies de Scapin” apo “Dredhít e Patukut” mund të vazhdojnë ta magjepsin publikun e thjeshtë, sepse hakmarrja e të dobëtëve ndaj të fortëve është një temë e përrjetshme.

Fishta me komedinë e përshtatur bëri jehonë që në gjalljen e tij dhe disa vjet më vonë. Pastaj ndodhi harresa e plotë. Vetë teksti u zhduk dhe Patuku nuk u ngjit më në skenë. Mbase me “dredhitë” e tij, jo aq të liga, mund të vijojë që të bëjë për të qeshur spektatorin. Në mos e arrihtë këtë, së paku, mund t’i bëjë të skuqen disa nga dredharakët e sotëm të tranzicionit, përballë të cilëve Patuku i Fishtës duket si një engjëll.

BIBLIOGRAFI

- A. SKANJETI, *100 vjet teatër në Shkodër 1879-1979*, Shtëpia Botuese “KAD”, Shkodër, 2002, 73, 121.
- A. UÇI, *Pesë të mëdhenjtë e letërsisë shqipe në optikën e një rileximi*, “Vatra”, Shkup, 2003, 73.
- CH-A.SAINTE-BEUVE, *Portraits littéraires*, tome II, nouvelle édition revue et corrigée, Paris, Garnier frères, 1862. Ont participé à cette édition électronique : Isma Bouhaddouf (Édition TEI), Frédéric Glorieux (Édition XML/TEI) et Vincent Jolivet (Édition XML/TEI). SorbonneUniversité, LABEOBVIL, 2014. http://obvil.sorbonne-universite.fr/corpus/critique/sainte-beuve_portraits-litteraires-ed-nouv_02.xml.
- E. TUPJA, *Këshilla një përkthyesi të ri*, Shtëpia botuese “Onufri”, Tiranë, 2007, 25
- F. MUZZIOLI, *Le teorie della critica letteraria*, La Nuova Italia Scientifica, Roma, 1994, 59
- Gj. FISHTA, *Dramatika III*, Botime Françeskane, Shkodër, 2009, 8, 16, 26, 117. 243.
- H. LACAJ, *At Fishta në dramatikë*, në A. B. DEMA OFM (ed.), *At Gjergj Fishta 1871-1940* (numër përkujtimuer), Shtypshkronja “Luarasi”, Tiranë, 1943, 256.
- I. LËNGU, *Teatri i Molierit dhe shoqëria frënge e shekullit XVII*, (parathënie), në *Komedi të zgjedhura*, Molier, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1980, 19-20.

suivie avec les lecteurs. On le retrouve pourtant en défiance continuelle de ce côté ; il craint les boutiques de la galerie du Palais ; il préfère être jugé aux chandelles, au point de vue de la scène, sur la décision de la multitude.

SAINTE-BEUVE, *Portraits littéraires*, https://obvil.sorbonne-universite.fr/corpus/sainte-beuve/sainte-beuve_portraits-litteraires-ed-nouv_02

- J. PAPAGJONI, *Teatri i Shkodrës*, Enti Botues “Gjergj Fishta”, Shkodër, 2009, 11.
- J. RROTA, *Me Pater Gjergjin*, në A. B. DEMA OFM (ed.), *At Gjergj Fishta 1871-1940* (numër përkujtimuer), Shtypshkronja “Luarasi”, Tiranë, 1943, 141-142.
- L. SHLLAKU, *Maska shkodrane - Kur lindej teatri*, Shtëpia botuese “Camaj – Pipa”, Shkodër, 2002, 156-157.
- MOLIÈRE, *Les Fourberies de Scapin*, Univers des Lettres Bordas, Paris, 2003, 19.
- MOLIÈRE: *Les fourberies de Scapin - comédie*, 1671, Paris, l’édition originale de 1671, 6-7, 14-15, 120-121. <https://www.theatre-contemporain.net/textes/les-fourberies-de-scapin/genese/>
- MOLIÈRE: *Les fourberies de Scapin - comédie*, 1671, Paris, l’édition originale de 1671, 123. <https://www.theatre-contemporain.net/textes/les-fourberies-de-scapin/genese/>
- P. DIADORI, *Teoria e tecnica della traduzione – Strategie, testi e contesti*, Le Monnier Università, Mondadori Education, Milano, 2012, 162-170.
- S. HAMITI, *Letërsia moderne shqipe*, UET/PRESS, Tiranë, 2009, 39.
- S. LANGER, *Ritmi komik*, në F. HYSAJ (ed.), *Teatrologji, dramaturgji, regjiturë dhe aktrim* – (antologji), Shtëpia botuese “Sythi”, Prishtinë, 2006, 182.
- V. KOKONA, *Fjalor frengjisht – shqip*, Botimet “Kokona” (Botim i pestë), Tiranë, 2002, 7.
- Z. HARAPI, *Fishta në lamë teatrale*, në A. B. DEMA OFM (ed.), *At Gjergj Fishta 1871-1940* (numër përkujtimuer), Shtypshkronja “Luarasi”, Tiranë, 1943, 261

Periodikë

- Bri Taraboshit, N’Vaso Pasha*: Gazeta “Taraboshi”, Shkodër, 2-3 shkurt 1914, 2-3.
- Dredhinat e Patukut*, Gazeta “Ora”, nr. 192, Tiranë, 11 tetor 1930, 4.
- L. SULA, *Drama e Fishtës, sprovë për tipologjinë e saj*, “Perla”, I (2004), 32.
- Nji copë e Moliere perkthye nën emrin “I ligu për mend” nga i nderti at Gjergj Fishta*, (Mbi shfaqjen e organizuar nga Shoqëria “Bogdani”), Gazeta “Zani i Popullit”, nr. 124, 1 janar 1928, 2.
- S. ÇAPALIKU, *Fishta dhe Molieri-Një sprovë krahasuese*, Gazeta “Rilindja”, Tiranë, 29 janar 1994, 8.